



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 1373 Prot.

Fier më 02.09. 2024

Lënda: Njoftim për dorëzim dokumentacioni për punësim nga jashtë portalit "Mësues për Shqipërinë" për vitin shkollor 2024-2025.

Në mbështetje të Ligjit 69/2012 datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, udhëzimit nr. 19, datë 29.08.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 8, datë 03.05.2024 "Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit "Mësues për Shqipërinë", i ndryshuar, kreu IV pika 13/1, ju njoftojmë si mëposhtë:

Kandidatët e interesuar për punësim të cilët nuk janë pjesë e portalit "Mësues për Shqipërinë", të paraqesin në rrugë postare në ZVAP Fier dokumentacionin për punësim nga jashtë si mëposhtë:

1. Kartë identiteti
2. Kërkesë për punësim nga jashtë
3. Diplomë dhe listë notash
4. Gjuhë të huaja (nëse ka)
5. Dëshmi kualifikimi (nëse ka)
6. Librezë pune (nëse ka)
7. Dëshmi penaliteti
8. Deklaratë për gjendjen gjyqësore

Dokumentacioni i sipërcituar të përcillet i njërsuar me originalin.

Afati për dorëzimin e dokumenteve të sipërcituara është data **03.09.2024**

Sqarim : Punësimi i kandidatëve të interesuar lidhur me këtë procedurë do të bëhet vetëm në rastet kur nuk ka kandidatë në portalin "Mësues për Shqipërinë" në profilet e kërkuar dhe në profilin e përafërt dhe as kandidatë në nivel DRAP-i.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTOR
Miglena Sofren

Adresa: Rr.Leon Rei, Fier

e-mail: ZVAFier@arsimi.gov.al

faqja web: zvapfier.gov.al